



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 16

Datë: 04. 05. 2023. Ora: 10:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### RENDI I DITËS

#### **1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

-Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr.08, 09 10 dhe 15/2023

#### **2. Certifikimi i rezultateve, për zgjedhjet e parakohshme për kuvendin Komunal në Leposaviq**

#### **3. Të ndryshme**

---

#### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Kreshnik Radoniqi**, pasi që e hapi mbledhjen, paraqiti agjendën e takimit dhe me vota unanime, u miratua rendi i ditës. Pastaj, me vota unanime u miratuan procesverbalet.

Ndërsa, pa kësaj u vazhdua me miratimin e rezultatit për komunën e Leposaviqit. Kryetari Radoniqi, e paraqiti një rekomandim të Sekretariatit, para se të miratohet rezultati i cili, nuk ishte miratuar në mbledhjen paraprake.

#### **2. Certifikimi i rezultateve, për zgjedhjet e parakohshme për kuvendin Komunal në Leposaviq:**

“Në bazë të nenit 64, rezultatet e zgjedhjet janë përfundimtare dhe detyruese, kur certifikohen nga KZQ. E kemi listën dhe rezultatin në formë tabelare, dhe ju e kemi pranuar këtë rekomandim”, tha kryetari Radoniqi.

**Sami Kurteshi**, tha se diskutimin e kemi shtjerrë për atë që kemi menduar ne. Vendimi është i domosdoshëm, kurse “interpretimi” i dhënë është i kundërligjshëm, dhe unë do të votoj kundër...

**Kreshnik Radoniqi**: Unë, tani do të lexoj rezultatet:

Lëvizja “Vetëvendosje!”, ka 76.%, ose 15 ulëse të fituara.

Partia Demokratike e Kosovës, ka 19.2%, ose me 2 ulëse të fituara.

Partia “Kosovski Serba”, ka 4.6% ose 2 ulëse të fituara.

Në “Listën e kandidatëve”, lëvizja “Vetëvendosje!” i ka 12 kandidatë që kanë marrë vota PDK i ka 2 kandidatë që kanë marrë vota, dhe partia “Kosovski Serba”, me 2 kandidat që kanë marrë vota.

A ka dikush lidhur me këtë rezultat ? Nëse nuk ka, kush është për certifikimin e rezultateve ?

Me 8 vota për, 2 vota kundër ( Sami Kurteshi dhe Alban Krasniqi ), dhe 1 abstenim (Gordana Llaban), certifikohet rezultati për zgjedhjet e parakohshme të mbajtura më 23 prill, 2023 për Kuvendin Komunal të Leposaviqit.

**Të ndryshme !**